



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA LIPJAN  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Dokument nr: 20-07 2017		
Lipjani:		
Nr. i Jedimita	Nr. i shtetit	Nr. i komunës
12-320	-38359	



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të neneve 19 dhe 20 të paragrafit 2 të Rregullores për kushtet, kriterët dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e datës 28.12.2016, dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për dhënjen e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerë 15Nr.400 – 33781 i datës 29.06.2017, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari bën këtë:

## RI - SHPALLJE

### I. Qëllimi i rishpalljes për aplikim

Qëllimi i rishpalljes për aplikim është përkrahja e fermerëve në fushën e perimkulturës dhe blegtoris sipas mundësive buxhetore për vitin 2017, fermerët do të përkrahen me serra në sipërfaqe prej 50 m<sup>2</sup>, dhe me makina mjelëse për lopë qumështore.

### II. Përfituesit e pranueshëm për serra

Përfituesit e pranueshëm janë personat fizik-fermer. Ata duhet të jenë banor të përhershëm të Komunës së Lipjanit si dhe prona duhet të jetë në territorin e Komunës së Lipjanit.

Fermerët duhet të posedojnë sipërfaqe të mjaftueshme të tokës bujqësore minimum 50 m<sup>2</sup>.

Përparësi kanë aplikuesit të cilët dëshmojnë se kanë vijuar trajnime relevante/specifike në lëmin e Perimkulturës.

Përparësi kanë fermerët e zonës ku është e zhvilluar perimkultura, përkatësisht fermerët që kanë mundësi të ujitjes.

Fermerët që kanë përfitur në vitin e kaluar serra mund të jenë përfitues, mirpo përparësi kanë ata fermer që nuk kanë qenë përfitues.

Nëse janë plotësuar në mënyrë të barabart kriteret e kërkuara aplikohet parimi “I pari vjen i pari shpërblehet” .

### III. APLIKUESIT PARAPRAK

Të gjithë aplikantët të cilët kanë aplikuar në thirrjen paraprake 12Nr.320-25196 të datës 18.05.2017 ju njihet e drejta e aplikimit dhe aplikacionet e tyre së bashku me aplikacionet e reja do të shqyrtohen nga komisioni.

#### **IV. Përfituesit e pranueshëm për makina mjelëse**

Përfituesit e pranueshëm janë personat fizik-fermer. Ata duhet të jenë banor të përhershëm të Komunës së Lipjani si dhe ferma duhet të jetë në territorin e Komunës së Lipjanit.

Të kenë 3 e më shumë krerë gjedhe qumështore. Gjedhet qumështore duhet të jenë të matrikuara KS (shenjëzuara).

Fermerët që kanë numër të madh të krerëve të gjedheve qumështore kanë përparësi në raport me fermerët që kanë numër më të vogël të gjedheve.

Fermerët që kanë marrëveshje me pikat grumbulluese të qumështit kanë përparësi.

Nëse janë plotësuar në mënyrë të barabart kriteret e kërkuara aplikohet parimi “I pari vjen i pari shpërblehet”.

#### **V. Dokumentet e bashkangjitura**

Aplikuesit duhet të dorëzojnë formularin për aplikim, së bashku me dokumentet e bashkangjitura:

- Kopja e letërnjoftimit
- Numri identifikues i fermerit (NIF),
- Projekti dhe plani financiar,
- Fletëposedim për patundshmëri,
- Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë,
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit,

#### **VI. Koha dhe mënyra e pranimit të aplikacioneve**

- Data e fillimit të dorëzimit të formularit për aplikim është dita pasi të jetë publikuar thirrja për aplikim,
- Thirrja për aplikim do të jete e hapur 15 ditë nga data e publikimit,
- Aplikacioni për plotësim mund të shkarkohet nga web-faqja e Komunës ose mund të merret në zyret e Drejtoratit të Bujqësisë dhe së bashku me dokumentat e bashkangjitura duhet të dorëzohet në zyret pritëse të Arhives së Komunës

## VII. Përzgjedhja

- Aplikimet kontrollohen, përzgjidhen dhe vlerësohen brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e fundit e dorëzimit të aplikacionit në kuadër të thirrjes aktuale për aplikim,
- Pasi që aplikacioni të jetë kontrolluar sa i përket tërësisë dhe përshtatshmërisë verifikohet aplikacioni në terren nga komisioni,
- Komuna e Lipjanit do të lidhë Marrëveshje me përfituesin e serrës ose të makinës mjelëse i cili obligohet që të mos e bëj tjetërsimin (shitje, dhënje në shfrytëzim etj.)

### *Sqarim:*

- Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet brenda periudhës së aplikimit. Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar dhe i pakompletuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.

### *Vërejtje:*

- Aplikimi mund të bëhet vetëm për një rënë masë (për serrë në sipërfaqe prej 50 m<sup>2</sup> apo për 1 makinë mjelëse për lopë qumështore).

**Lipjan**

20.07.2017

Drejtori i Bujqësisë  
Feti Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## APLIKACION PËR NGRITJEN E SERRËS NË SIPËRFAQE PREJ 50 m<sup>2</sup>

### 1. Të dhënat për aplikuesin

Emri, emri i babës dhe mbiemri i aplikuesit \_\_\_\_\_

Adresa, Fshati, Komuna \_\_\_\_\_ Nr tel. \_\_\_\_\_

### 2. Të dhënat për sipërfaqen e tokës dhe furnizimit me ujë

Sipërfaqe e tokës \_\_\_\_\_ ha, tokë nën ujitje \_\_\_\_\_ ha,

Furnizimi me ujë: \_\_\_\_\_, Ujësjellësi \_\_\_\_\_, Pusi \_\_\_\_\_, Burim tjetër \_\_\_\_\_

Arsyeja qe jeni i interesuar \_\_\_\_\_

Me aplikacion duhet të bashkëngjitni edhe dokumentet e nevojshme:

- Kopja e letërnjoftimit
- Numri identifikues i fermerit (NIF),
- Projekti dhe plani financiar,
- Fletëposedim për patundshmëri,
- Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë,
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit,

Vendi \_\_\_\_\_, Data \_\_\_\_\_, Nënshkrimi i aplikuesit \_\_\_\_\_



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## APLIKACION PËR FERMERË / MAKINA MJËLESE

### 1. Të dhënat për Fermerin

Emri, emri i babës dhe mbiemri i aplikuesit \_\_\_\_\_, Viti i themelimit të fermës \_\_\_\_\_

Vendbanimi \_\_\_\_\_, Komuna \_\_\_\_\_, Nr. tel. \_\_\_\_\_, Sa anetarë të familjes keni \_\_\_\_\_

### 2. Kushtet e Fermës

Madhësia e fermës m<sup>2</sup> \_\_\_\_\_, nr. i lopëve që keni momentalisht \_\_\_\_\_

**Me aplikacion duhet të bashkëngjitni edhe dokumentet e nevojshme:**

- Kopja e letërnjoftimit
- Numri identifikues i fermerit (NIF),
- Projekti dhe plani financiar,
- Fletëposedim për patundshmëri,
- Dëshmi nga veterinari për numrin e lopëve qumështore
- Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë,
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit,

Vendi \_\_\_\_\_, Data \_\_\_\_\_, Nënshkrimi i aplikuesit \_\_\_\_\_